# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

**www.qbz.gov.al**

**Nr. 77 — 13 maj — 2013**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 127/2013 datë 25.4.2013 | Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna'a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit të Durrësit ..... | 3307 |

**LIGJ**
**Nr. 127/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja Istisna'a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit të Durrësit.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8145, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

Projekti nr. ALB-0035

**MARRËVESHJE ISTISNA'A**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM LIDHUR ME PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT NË DURRËS, SHQIPËRI

Kjo marrëveshje është lidhur më____/____/____/H (që korrespondon me ____/____/____G), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si blerës (në vijim referuar si "Blerësi") dhe Bankës Islamike për Zhvillim si shitës (në vijim referuar si "Shitësi").

Blerësi dhe Shitësi referohen kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala".

Meqenëse:

A) Blerësi i ka kërkuar Shitësit të financojë ndërtimin e punimeve siç përshkruhet në shtojcën I (në vijim referuar si "punimet") nëpërmjet Istisna'a për t'u përdorur në projektin e ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës, siç përshkruhet në aneksin II (në vijim referuar si "projekti");

B) Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Shitësit ka miratuar në datë 24/08/1433H (që korrespondon me datën 14/07/2012G) ndërtimin e punimeve për projektin, në një shumë që nuk tejkalon 7.580.000 USD (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë), përafërsisht

ekuivalente me 4,900,000 ID (katër milionë e nëntëqind mijë dinarë islamikë), (në vijim referuar si "shuma e miratuar").

C) Çmimi i shitjes do të paguhet nga Blerësi te Shitësi për 15 (pesëmbëdhjetë) vjet pas një periudhe drejtimi prej 3 (tri) vitesh. Këto afate dhe kushte janë komunikuar dhe janë pranuar nga ana e Blerësit.

D) Marrëdhëniet midis Shitësit dhe Blerësit janë ato të shitësit dhe blerësit, sipas parimeve të Sheriatit Islamik, siç interpretohet nga Akademia Islamike Fiqh dhe shpallur në Standardet e Sheriatit, publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI).

Në vijim, Shitësi dhe Blerësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1
**Përkufizimet - interpretimi**

1.1 Në këtë marrëveshje, përveç rasteve kur nga konteksti rezulton ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që paraqitet në krah të secilit prej tyre si vijon:

"Marrëveshja e agjencisë", marrëveshja e së njëjtës datë lidhur midis Shitësit dhe Blerësit, ku Blerësi do të veprojë si agjenti i Shitësit në mbikëqyrjen e ndërtimit të punimeve.

"Shuma e miratuar", shuma e specifikuar më lart në përshkrimin B.

"Punimet", punimet e përshkruara në aneksin I.

"Dita e punës", çdo ditë në të cilën bankat janë zyrtarisht të hapura për punë në vendin ku një shumë ose shumat paguhen nga Blerësi te Shitësi në monedhën në të cilën do të kryhen pagesa të tilla.

"Kosto kapitale", kostoja totale e ndërtimit të punimeve, e cila do të përfshijë çmimin e kontratës dhe çdo kosto ose shpenzim tjetër, të shkaktuar nga Shitësi në lidhje me ndërtimin e punimeve, plus një normë e lëvizshme e ngritjes së çmimit e Libor USD 6-mujore plus 135 pikë bazë në vit që aplikohen për çdo disbursim gjatë periudhës së drejtimit.

"Kontrata", kontrata për ndërtimin e punimeve të përfunduara në emër të Shitësit nga Blerësi përmes agjencisë zbatuese me kontraktuesin.

"Çmimi i kontratës", çmimi që i paguhet kontraktuesit për ndërtimin e punimeve.

"Kontraktuesi", kontraktuesi që ngarkohet për ndërtimin e punimeve.

"Disbursim", çdo pagesë e shumës së miratuar.

"Data e vlefshme", data në të cilën Shitësi e deklaron këtë marrëveshje që ka hyrë në fuqi në përputhje me nenin 9.

"Agjencia zbatuese", Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Republika e Shqipërisë.

"Disbursimi i parë" pagesa e parë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje në përputhje me politikat dhe udhëzimet përkatëse të Shitësit.

"Periudha e drejtimit", periudha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe mbaron pas 3 (tri) vitesh.

"LIBOR"

i) Në lidhje me çdo periudhë përkatëse prej një (1) muaji ose më shumë, norma e interesit për depozitat për një periudhë që është numri i të gjithë muajve që korrespondojnë më shumë me kohëzgjatjen e periudhës; dhe

ii) Në lidhje me një periudhë përkatëse më pak se një muaj, norma e interesit për depozitat në USD për një periudhë prej një (1) muaji (periudha për të cilën është marrë norma, duke u quajtur në vijim "periudha përfaqësuese"), siç është përcaktuar nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe lëshuar nga Shërbimi Reuter i Normave të Monitorimit të Parave apo çdo ofrues financiar i lajmeve, në 11:00 paradite me orën e Londrës ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme për Shitësin në

ditën (data e rivendosjes), e cila bie dy (2) ditë pune londineze para ditës së parë të periudhës përkatëse.

Nëse një normë e tillë nuk lëshohet nga Reuter apo ndonjë ofrues i lajmeve financiare, Shitësi do të kërkojë zyrat kryesore të "bankave të referencës" në Londër, për të kuotuar normën në të cilën depozitat në USD janë ofruar në një sasi të krahasueshme nga secila prej tyre, përafërsisht në 11:00 paradite, sipas orës së Londrës në datën e rivendosjes, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Londrës, për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kuotime të tilla, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve të dhëna.

Nëse jepen më pak se dy kuotime, ashtu siç kërkohet, Shitësi do të kërkojë zyrat kryesore të qytetit të Nju-Jorkut të bankave të referencës, për të kuotuar normën, në të cilën depozitat në USD ofrohen në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre, afërsisht në 11:00 paradite me orën e qytetit të Nju-Jorkut, në ditën që bie dy (2) ditë pune njujorkeze, pas datës së rivendosjes, për bankat kryesore në tregun europian, për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse të paktën sigurohen dy kuotime të tilla, norma do të jetë mesatarja aritmetike e kuotimeve të ofruara.

Për qëllime të përkufizimit të mësipërm:

i) Dita e punës së Londrës: një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë normale në Londër dhe dita e punës së Nju-Jorkut do të thotë një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë normale në qytetin e Nju-Jorkut.

ii) Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga çdo llogaritje e përmendur në këtë përkufizim do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme në pesë numra pas presjes dhjetore.

iii) Shitësi duhet të informojë pa vonesë Blerësin mbi kuotimet e marra nga Shitësi.

iv) Bankat e referencës: zyrat kryesore në Londër të JPMorgan Chase, Citibank N.A. dhe HSBC dhe/ose çdo bankë tjetër e caktuar nga Shitësi në zëvendësim të ndonjë prej bankave të mësipërme.

"Projekti" ka kuptimin e përcaktuar në përshkrimin A më sipër.

"Praktikat e sanksionueshme", secila nga praktikat e korruptuara, praktika shtrënguese, praktikat e fshehta, mashtruese ose praktikat penguese:

a) "Praktika e korruptuar" do të thotë ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në veprimet e një Pale tjetër;

b) "Praktika shtrënguese" nënkupton çdo veprim ose mosveprim që cenon, dëmton, kërcënon për të cenuar ose për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo Palë ose pronë e palës për të ndikuar në mënyrë të paligjshme veprimet e një Pale.

c) "Praktika e fshehtë" do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e hartuar për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të paligjshme në veprimet e një Pale tjetër.

d) "Praktika mashtruese" nënkupton çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë një shtrembërim, që mashtron me dashje ose nga pakujdesia, ose tenton të mashtrojë një Palë për të marrë një përfitim financiar ose tjetër, ose për të shmangur një detyrim.

e) "Praktika penguese" do të thotë:

i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose marrjen e deklaratave të rreme nga hetuesit, në mënyrë që të pengohet materialisht hetimi i Shitësit në akuzat për një praktikë të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, dhe/ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit,

ose veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të Shitësit në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin e Shitësit në akuzat e një praktike të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

"Çmimi i shitjes", çmimi i punimeve i pagueshëm nga Blerësi te Shitësi në përputhje me nenin 4.

"Norma e shkëmbimit", norma që do të zgjidhet nga Shitësi për llogaritjen e çmimit të Shitjes, një ditë pune para përfundimit të periudhës së drejtimit, nga norma më e ulët që merret kur krahasojmë:

a) normat e kuotuara dhe të marra nga institucione që merren me shkëmbime të pranueshme për Shitësin; dhe

b) normat e kuotuara në Bloomberg ose ndonjë ofrues tjetër i lajmeve financiare të pranueshme për Shitësin.

Për të qenë sa më të qartë, çdo normë që do të merret ose llogaritet, do të jetë për një shkëmbim amortizimi fiks-qarkullues që ka zero NPV në fillim, për të cilën:

i) valuta e dy fazave është në dollar amerikan;

ii) të dyja fazat kanë një maturim të barabartë me periudhën e ripagesës;

iii) të dyja fazat janë subjekt i programit të rënë dakord të amortizimit të kostos së kapitalit;

iv) faza fikse ka një pagesë kuponi me frekuencë gjashtëmujore dhe bazë numërimi 30/360 ditë;

v) faza e ndryshueshme ka një pagesë kuponi prej 6-muajsh USD Libor (d.m.th. me frekuencë gjysmëvjetore dhe baza numërimi aktuale/360-ditore),

të dyja fazat përdorin kurba shkëmbimi mesatare të disponueshme në Bloomberg (Menaxher i Shkëmbimit - SWPM) për qëllime çmimi. Në këtë rast, norma e shkëmbimit do të jetë kuponi i fazës fikse.

"Taksat", çdo taksë, vënie taksash, tatim, detyrim ose detyrime të tjera të kësaj natyre (duke përfshirë pa kufizim çdo gjobë të pagueshme në lidhje me çfarëdo mospagimi ose vonese në pagesën e secilës prej tyre).

"Dollari US/USD/US$", monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.2 Në këtë marrëveshje:

i) Vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që paraqesin personat përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referencat në një aneks të caktuar, shtesa, nen ose seksion është një referencë për atë aneks shtesë, nen ose seksion të kësaj marrëveshjeje.

ii) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në marrëveshjen e agjencisë dhe jo të përkufizuara këtu, do të kenë të njëjtin kuptim që i është dhënë në marrëveshjen e agjencisë.

Neni 2
**Ndërtimi dhe përfundimi i punimeve**

2.1 Shitësi bie dakord të ndërtojë punimet në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe Blerësi bie dakord të marrë përsipër punimet, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe për të paguar çmimin e shitjes.

2.2 Për shmangien e çdo dyshimi, Blerësi pajtohet që Shitësi t'i ndërtojë punimet nga kontraktuesi i caktuar në përputhje me dispozitat përkatëse të shënuara në marrëveshjen e agjencisë.

2.3 Në bazë të nenit 3 dhe 6, ndërtimi i punimeve do të përfundojë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh nga data e pagesës së parë.

Neni 3
**Pranimi dhe statusi i punimeve**

3.1 Blerësi do të drejtojë agjencinë zbatuese të pranojë në mënyrë të parevokueshme punimet për të gjitha qëllimet e saj, kur agjencia zbatuese nënshkruan certifikatën përfundimtare të pranimit.

3.2 Gjendja e punimeve. Pa paragjykuar sa më sipër, Shitësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ose detyrim për Blerësin ose për ndonjë person apo subjekt tjetër, në lidhje me:

a) çfarëdo përgjegjësie, humbjeje ose dëme të shkaktuara (ose të pretenduara për t'u shkaktuar) drejtpërdrejt ose tërthorazi në punime ose nga çdo mangësi ose pasaktësi ose defekt aty apo nga ndonjë rrethanë tjetër në lidhje me këtë;

b) në lidhje me përdorimin ose operimin e punimeve ose ndonjë rrezik që lidhet me to;

c) çdo ndërprerje e shërbimit, humbje e punës ose fitim i parapaguar ose dëme vijuese.

3.3 Shitësi merr përsipër të caktojë për Blerësin përfitimin e çdo garancie, kushti ose sigurie, në lidhje me punimet që mund të jenë dhënë nga kontraktuesi te shitësi dhe të cilat janë kontrolluar dhe pranuar nga ana e Blerësit dhe të gjitha kushtet e tjera ose garancitë siç mund të nënkuptohet nga ligji ose të njohura zakonisht në favor të Shitësit. Përveç kësaj, Shitësi duhet të ndërmarrë veprime të tjera që mund të kërkohen nga Blerësi, në mënyrë të arsyeshme për t'i mundësuar Blerësit për të pretenduar ndaj kontraktuesit.

3.4 Pronësia dhe rreziku. Pronësia dhe rreziku në punime do të kalojnë te Blerësi me nënshkrimin e certifikatës përfundimtare të pranimit.

Neni 4
**Pagesa e çmimit të shitjes**

4.1 Çmimi i shitjes është 8,917,930.00 USD (tetë milionë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë dollarë amerikanë).

4.2 i) Çmimi i shitjes do të rillogaritet në fund të periudhës së drejtimit bazuar në koston e kapitalit plus një ngritje çmimi e normës së shkëmbimit 6-mujore Libor USD që mbizotëron në kohën që korrespondon me periudhën e amortizimit të kapitalit plus 135 pikë bazë në vit.

ii) Kostoja e kapitalit do të përcaktohet në bazë të pagesës së shumave totale në fund të periudhës së drejtimit, ose në kohën e shitjes, plus një normë e ndryshuar e ngritjes së çmimit e Libor USD 6-mujore plus 135 pikë bazë në vit.

4.3 Blerësi duhet të paguajë çmimin e shitjes në 30 (tridhjetë) këste gjysmëvjetore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet i pagueshëm gjashtë muaj nga fundi i periudhës së drejtimit. Shitësi do t'i dërgojë blerësit programin e pagesës së çmimit të shitjes, menjëherë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit.

4.4 Sipas nenit 4.6 dhe 4.7, çdo pagesë që do të kryhet nga ana e Blerësit për Shitësin, duhet të bëhet në çdo monedhë të konvertueshme të pranueshme nga Shitësi për vlerën në datën e duhur për llogari të Shitësit ose në ndonjë mënyrë tjetër, ashtu si Shitësi mund të njoftojë herë pas here Blerësin në shkrim.

4.5 Çdo pagesë do të konsiderohet se është paguar rregullisht, kur bankat në vijim i konfirmojnë Shitësit marrjen e pagesës në llogarinë e Shitësit në:

| **Në Dollar US** | **Në Paund Sterlina** | **Në euro** |
|---|---|---|
| Llogaria nr: | Llogaria nr: | Llogaria nr: |
| GB36SINT60928000159111 | GB13SINT60928000159137 | FR7643899000019696500151088 |
| Gulf International Bank (UK) | Gulf International Bank (UK) | Union De Banques Arabes Et |
| Ltd, One Knightsbridge | Ltd, One Knightsbridge | Françaises (UBAF) |
| London SW1X 7XS | London SW1X 7XS | 92523 Paris, Neuilly Cedex |
| Mbretëria e Bashkuar | Mbretëria e Bashkuar | Francë |
| Teleks nr. 8812261/2 | Teleks nr. 8812261/2 | Teleks nr. 610334 UBAF |
| Kodi Swift: SINTGB2L | Kodi Swift: SINTGB2L | Kodi Swift: UBAFRPPXXX |

4.6 Nëse ndonjë pagesë bie në një ditë që nuk është ditë pune, pagesa do të kryhet në ditën pasuese të punës që vijon.

4.7 Të gjitha pagesat e kryera nga Blerësi do të jenë të lira dhe të qarta dhe pa zbritje ose mbi llogari të ndonjë takse, dërgimi, kundërpadie ose çështje të tjera. Nëse Blerësi është i detyruar me ligj që të bëjë ndonjë zbritje ose mbajtje të ndonjë shume të pagueshme, sipas kësaj marrëveshjeje, shuma e pagueshme prej tij në lidhje me të cilën kjo zbritje ose mbajtje është e nevojshme për t'u bërë, do të rritet në masën e nevojshme për të siguruar që, pas kryerjes së një zbritjeje të tillë ose mbajtjeje, Shitësi merr dhe ruan (i lirë nga çdo përgjegjësi në lidhje me ndonjë zbritje të tillë ose mbajtje), një shumë neto të barabartë me shumën që ai do të ketë marrë dhe do të ketë mbajtur, në mënyrë të tillë që asnjë zbritje ose mbajtje do të ishte kryer.

4.8 Nëse Blerësi nuk paguan asnjë shumë të pagueshme që duhet sipas kësaj marrëveshjeje, Blerësi:

i) në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik, duhet të kompensojë Shitësin për çdo humbje, dëmtim, kosto të arsyeshme aktuale dhe shpenzime (duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në ndonjë kosto dhe shpenzim të grumbulluar ligjor të agjentit), shkaktuar nga Shitësi si një rezultat i vonesës së pagesës për Shitësin.

ii) do t'i paguajë Shitësit një kamatëvonesë në lidhje me shumën e papaguar. Çdo kamatëvonesë e tillë do të llogaritet dhe zbatohet si një shumë e caktuar nga Shitësi, pas aplikimit të formulës siç tregohet më poshtë:

$\frac{AxBxC}{360}$ ku: "A" nënkupton shumën e papaguar;
"B" nënkupton 01% në vit; dhe
"C" do të thotë numri i ditëve nga dhe duke përfshirë një datë të tillë, dhe duke përfshirë datën e pagesës aktuale (qoftë para ose pas vlerësimit).

Pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve aktuale të kryera, Shitësi do paguajë çfarëdo shume të marrë në pajtim me këtë nen në llogarinë e fondit të shitësit Waqf.

| | |
|---|---|
| Emri i llogarisë: | Llogaria e Fondit të Shitësit Waqf |
| Nr. i llogarisë: | 0000 100 102 |
| Emri i bankës: | Banka Britanike Arabe Tregtare |
| Kodi SWIFT: | BACMGB2L |
| IBAN: | GB69 BACM 4051 3200 100 102 |

Neni 5
**Anulimi, pezullimi dhe ndërprerja**

5.1 Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e vlefshme, kontrata nuk është nënshkruar apo Blerësi nuk ka kërkuar për pagesën e parë, Shitësi me njoftim për Blerësin mund të anulojë shumën e miratuar, përveç nëse ajo përmbushet duke u justifikuar nga Blerësi për një vonesë të tillë.

5.2 Blerësi mund t'i kërkojë Shitësit të përfundojnë këtë marrëveshje dhe të anulojnë shumën e miratuar ose ndonjë pjesë të saj në çdo kohë para nënshkrimit të kontratës.

5.3 Para nënshkrimit të kontratës, Shitësi duke njoftuar Blerësin, mund të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Mund të jetë krijuar një situatë e jashtëzakonshme, e cila:

i) sipas mendimit të arsyeshëm të Shitësit, do ta bëjë atë të pamundur që Blerësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje; ose

ii) do të pengojë arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo marrëveshje;

b) Një përfaqësim i kryer nga ana e Blerësit ose ndonjë deklaratë e dhënë dhe që ka për qëllim të mbështetet nga Shitësi në përpunimin e projektit për miratim ose për të lidhur këtë marrëveshje, do të ketë qenë i paplotë ose i pasaktë në çdo aspekt material.

5.4 Në çdo kohë Shitësi përcakton, pas konsultimit me Blerësin, se nuk do të jetë e nevojshme çdo pjesë e shumës së miratuar për të financuar projektin. Shitësi mund të njoftojë Blerësin, duke përfunduar ndërmarrjen nga Shitësi, për të shpaguar një pjesë të tillë. Kjo pjesë e shumës së miratuar do të konsiderohet e anuluar pas dhënies së një njoftimi të tillë.

5.5 Shitësi mund të përfundojë ose pezullojë këtë marrëveshje dhe/ose të anulojë shumën e miratuar ose ndonjë pjesë të saj, nëse shitësi përcakton se:

i) Blerësi është në shkelje të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

ii) në lidhje me zbatimin e ndonjë kontrate për t'u financuar plotësisht ose pjesërisht nga fondet e financimit, çdo person ose entitet është angazhuar në çdo praktikë të sanksionueshme dhe Blerësi nuk ka marrë masa në kohë, të përshtatshme dhe të kënaqshme për Shitësin për të korrigjuar situatën apo për të adresuar praktika të tilla kur ato ndodhin.

5.6 Në rast se kontraktuesi dështon të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas Kontratës dhe Blerësi, duke u konsultuar me Shitësin, zgjidh Kontratën në përputhje me kushtet e saj, ky përfundim do të veprojë pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh si një anulim i çdo shume të mbetur e papaguar nga shuma e miratuar, përveç nëse Shitësi bie dakord ndryshe.

5.7 Çdo pezullim i marrëveshjes ose i shumës së miratuar do të vazhdojë derisa ngjarja apo ngjarjet, të cilat i dhanë nismën një pezullimi të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Shitësi do të ketë njoftuar Blerësin dhe është rikthyer me ndërmarrjen e Shitësit për të siguruar punimet, cilado që është më herët, me kusht, që në rast të ndonjë njoftimi të tillë të rikthimit, ndërmarrja për ndërtimin e punimeve do të rikthehet vetëm në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në njoftimin e tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose pengojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose rregullim të Shitësit në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër ose të mëvonshme përshkruar në këtë nen.

5.8 Pas përfundimit të kësaj marrëveshjeje për shkak të një rasti mospërmbushjeje, Blerësi do të dëmshpërblejë Shitësin me një shumë të barabartë me shpenzimet kapitale, përcaktuar në datën e përfundimit.

5.9 Pjesa e papaguar e shumës së miratuar do të anulohet automatikisht në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje ose marrëveshjes së agjencisë.

5.10 Veç nëse shpagimi është kryer nga shuma e miratuar, nëse shuma e miratuar është anuluar në pajtim me këtë nen, marrëveshja do të konsiderohet e ndërprerë automatikisht.

5.11 Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, Blerësi do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të ndihmojë Shitësin në rregullimin nga kontraktuesi të një pjese të tillë të çmimit të kontratës dhe çdo shume tjetër që mund të ketë qenë shpaguar nga Shitësi para përfundimit të kontratës.

5.12 As Shitësi dhe as Blerësi nuk do të kenë asnjë detyrim të mëtejshëm për tjetrin nga data e përfundimit të marrëveshjes në bazë të këtij neni, me kusht që një ndërprerje e tillë nuk do të ndikojë në asnjë detyrim shkaktuar ose të akumuluar drejt për çdo Palë para një përfundimi të tillë.

## Neni 6
## **Përfaqësimi**

Blerësi paraqet se:

i) ai ka të drejtën për të lidhur këtë marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij në këtë marrëveshje dhe të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin e kësaj marrëveshje dhe performanca nga Blerësi e detyrimeve të tij është marrë në mënyrë të rregullt;

ii) detyrimet e shprehura për t'u marrë nga ana e Blerësit në këtë marrëveshje janë detyrime ligjore dhe të vlefshme të detyrueshme për Blerësin në përputhje me kushtet;

iii) zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe përmbushja e detyrimeve të Blerësit nuk përbëjnë dhe nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje të ndonjë marrëveshjeje, traktati apo ligji;

iv) të gjitha aktet, kushtet dhe sendet (duke përfshirë shkëmbimin e pëlqimeve të kontrollit) të kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, janë përmbushur dhe kryer në mënyrë që:

a) të mundësojnë Blerësin për të lidhur këtë marrëveshje në mënyrë të ligjshme dhe për të kryer detyrimet e shprehura marrë nga ai;

b) të sigurojë që detyrimet e shprehura marrë nga ai në këtë marrëveshje janë ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

c) për të bërë këtë marrëveshje të pranueshme si dëshmi në Republikën e Shqipërisë pa hapa të mëtejshëm ose formalitetet të jenë bërë, plotësuar dhe kryer në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

v) nuk është filluar dhe nuk është kërcënuar asnjë veprim ose procedim administrativ para ndonjë gjykate ose agjencie, të cilat mund të kenë një efekt material negativ në gjendjen financiare të Blerësit;

vi) sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi në datën e kësaj marrëveshjeje, pretendimet e Shitësit kundër Blerësit sipas kësaj marrëveshje do të renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasigurt për çdo borxh të Blerësit.

Neni 7
**Rastet e mospërmbushjes**

7.1 Nëse një nga rastet e përcaktuara në këtë nen do të ketë ndodhur dhe vazhdon të ndodhë, atëherë Shitësi, duke njoftuar Blerësin, mund të deklarojë që të paguhet menjëherë i gjithë ose një pjesë e çmimit të shitjes (çdo gjë në këtë marrëveshje, pavarësisht) pa asnjë njoftim të mëtejshëm:

a) mosplotësimi duhet të ketë ndodhur në pagesën e ndonjë prej kësteve të çmimit të shitjes dhe një mosplotësim i tillë ka vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

b) mosplotësim, përveç nëse mosplotësimi i specifikuar në nenin 7.1 (a), duhet të ketë ndodhur në kryerjen e ndonjë detyrimi të Blerësit në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe një mosplotësim i tillë vazhdon për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

c) çdo përfaqësim ose garanci konfirmuar apo kryer nga ana e Blerësit në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e kësaj marrëveshjeje ose në lidhje me ndonjë kërkesë për pagesë, sipas kësaj marrëveshjeje, mendohet se ka qenë e pasaktë në çfarëdo aspekti material dhe vazhdon të jetë e gabuar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit që i është dhënë Blerësit nga Shitësi;

d) Blerësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij ashtu si duhet ose përndryshe ka falimentuar; ose çdo mbajtës i garancisë do të ketë marrë ligjërisht zotërim ose do të jetë caktuar një marrës ose administrues i besuar për të gjithë ose ndonjë pjesë të sipërmarrjes ose aseteve të Blerësit; ose një fatkeqësi ose ekzekutim (ose proces i ngjashëm) është vënë, zbatohet ose lëshohet kundër ndonjë pasurie të luajtshme ose pronë të Blerësit dhe një fatkeqësi e tillë apo ekzekutim nuk do të jetë paguar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh; apo është dhënë një porosi ose ka kaluar një zgjidhje efektive apo procedura të ngjashme ndërmarrë për likuidimin e Blerësit, falimentimi apo shpërbërja; apo çdo ngjarje tjetër ndodhur në bazë të një ligji në fuqi do të ketë një efekt analog me secilën nga ngjarjet e renditura më sipër në këtë paragraf;

e) ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme;

7.2 Nëse ndodh ndonjë rast mospërmbushjeje ose çfarëdo ngjarjeje, e cila me kalimin e kohës ose njoftim dhe me kalimin e kohës kthehet në një rast mospërmbushjeje, Blerësi do të njoftojë menjëherë Shitësin me teleks ose faks, duke specifikuar natyrën e rastit të tillë të mospërmbushjes ose rast të tillë dhe çdo hap që Blerësi merr për të korrigjuar një gjë të tillë.

7.3 Asnjë vazhdim marrëveshjeje dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosveprim për të ushtruar çdo të drejtë, kompetencë apo rregullim që rrjedh për Shitësin mbi çdo mosplotësim, sipas

kësaj marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje tjetër do të pengojë një të drejtë të tillë, kompetencë, apo rregullim ose të interpretohet që të jetë një heqje dore prej tyre ose pranim i heshtur; as veprimi i Shitësit në lidhje me ndonjë mungesë të tillë, apo ndonjë pranim i heshtur nga ai aty, nuk do të ndikojë apo pengojë asnjë të drejtë, kompetencë ose rregullim të Shitësit në lidhje me ndonjë mosplotësim tjetër.

Neni 8
**Dëmshpërblimi**

8.1 Blerësi merr përsipër të dëmshpërblejë Shitësin, mbi një bazë neto pas tatimit (me normat e zbatueshme vendase dhe të huaja tatimore), dhe pajtohet për të mbrojtur, ruajtur dhe për të mbajtur të padëmshëm Shitësin nga çdo dhe të gjitha detyrimet, taksat, përgjegjësitë, humbjet, dëmtimet, dënimet, kërkesat, veprimet, gjykimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat ligjore të arsyeshme dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifa ligjore të tilla dhe shpenzime të shkaktuara në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje), të çdo lloji dhe natyre të vendosur, të shkaktuar nga, ose pohuar kundër Shitësit që rrjedhin nga:

a) pronësia, posedimi, përdorimi, dokumentacioni, heqja, kthimi, apo zbatime ose dispozita të tjera sipas kontratës ose marrëveshjes së konsulencës, duke përfshirë se këto mund të lindin nga:

i) çdo humbje ose dëmtim i çdo prone apo vdekje ose plagosje e çdo personi;

ii) patentë ose defekte të fshehta në punime;

iii) çdo pretendim i bazuar në përgjegjësinë e saktë në delikti ose ndryshe;

iv) çdo kërkesë bazuar në shkeljen e patentës, markës tregtare ose në të drejtën e autorit;

v) çdo kërkesë bazuar në përgjegjësinë që rrjedh sipas ligjeve të zbatueshme ose miratimeve mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me pronësinë e punimeve ose të truallit, mbi të cilin është ndërtuar;

vii) çdo pretendim apo mosmarrëveshje në lidhje me kontratën ose ndonjë letër krediti vendosur në pajtim me to.

b) shfaqja e ndonjë mosplotësimi ose ndonjë mospërmbushjeje tjetër nga ana e Blerësit ose Kontraktuesit për të kryer ose të pajtuar me çdo kusht të kësaj marrëveshje, ose çdo dokument, marrëveshje ose kontratë të lidhur në lidhje me këtë dokument ose ndryshe në raport me punimet, por duke përjashtuar çdo pretendim të bazuar mbi çdo dështim nga ana e Shitësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje ose çdo dokument, marrëveshje apo kontratë të lidhur nga Shitësi në lidhje me këtë ose ndryshe në raport me punimet;

c) çdo kërkesë, pengesë, interesat e sigurisë dhe pengesë si garanci ose proceset ligjore lidhur me pronësinë ose interesin në punime apo tokën, mbi të cilën është ndërtuar.

8.2 Blerësi do ta njoftojë menjëherë shitësin për shfaqjen e ndonjë kushti të njohur për Blerësin, si pasojë e të cilit Shitësi ka apo ka të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të drejtën për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi dhënë në nenin 8.1, do të zbatohet posaçërisht dhe do të përfshijë kërkesat ose veprimet e paraqitura nga ose në emër të punonjësve të Blerësit dhe Blerësi, do të heqë dorë shprehimisht, ashtu si kundër Shitësit, nga çdo imunitet për të cilin Blerësi përndryshe mund të ketë të drejtë në bazë të ndonjë ligji të zbatueshëm. Me kërkesë të Shitësit (por në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga një kërkese të tillë), Blerësi duhet të rimbursojë menjëherë Shitësin për shumat e shpenzuara nga ai në lidhje me ndonjë nga sa më sipër, ose të paguajë drejtpërdrejt shuma të tilla. Blerësi do të funksionojë me të drejtat e Shitësit në çdo çështje, në lidhje me të cilat Blerësi ka rimbursuar si duhet Shitësin për shumat e shpenzuara prej tij, ose ka paguar drejtpërdrejt shuma të tilla në pajtim me nenin 8.1. Në rast se ndonjë veprim ose procedim është paraqitur kundër Shitësit në lidhje me ndonjë pretendim të dëmshpërblyer, pas marrjes së njoftimit të fillimit të një veprimi ose procedimi të tillë, Shitësi do të njoftojë Blerësin e tij, duke bashkëngjitur një kopje të të gjitha dokumenteve dorëzuar Shitësit. Me kërkesë të Shitësit, Blerësi mund të rezistojë dhe të

mbrojë një veprim të tillë apo akte në ngarkim të Blerësit, ose të shkaktojë të njëjtën gjë për të rezistuar ose mbrojtur nga avokati i zgjedhur nga ana e Blerësit në mënyrë të arsyeshme dhe me dëshirën e Shitësit. Në rast të ndonjë dështimi nga ana e Blerësit për ta kryer sa më lart, Blerësi do të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit) të shkaktuara nga Shitësi në lidhje me këtë veprim apo procedim.

Neni 9
**Efikasiteti**

9.1 Kjo marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi nëse dhe derisa Blerësi t'i sigurojë Shitësit një opinion ligjor të Ministrit të Drejtësisë së Blerësit kryesisht në formën e parashikuar në aneksin III.

9.2 Nëse marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit, marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë, përveç nëse Shitësi, pas shqyrtimit të arsyeve për vonesën, do të vendosë një datë më të vonë për qëllimet e këtij neni. Shitësi duhet të informojë menjëherë Blerësin për këtë datë të mëvonshme ose përfundimin e Marrëveshjes, siç mund të jetë rasti.

Neni 10
**Heqja dorë**

Dështimi i Shitësit për të ushtruar ose pohuar ndonjë nga të drejtat e tij sipas kësaj marrëveshjeje ose vonesë e tij në të njëjtën ose dështimi i tij për të ushtruar ose pohuar çdo rregull që mund të ketë kundër Blerësit ose vonesës së tij në të njëjtën gjë, nuk do të paragjykojë një të drejtë të tillë apo rregullim dhe nuk duhet të interpretohet si një heqje dorë nga një e drejtë e tillë ose rregullim.

Neni 11
**Ligji i zbatueshëm - zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

11.1 Kjo marrëveshje do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islam të shqiptuara nga ana e Akademisë Islame Fiqh, të shpallura në Standardet e Sheriatit publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI), dhe interpretohet nga Komiteti i Sheriatit të Shitësit.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë marrëveshje dhe çdo pretendim nga çdo palë për palën tjetër që lind në këtë marrëveshje, i cili nuk mund të zgjidhet me marrëveshje të palëve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e njoftimit nga njëra Palë te tjetra, do të dorëzohet para një paneli arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyrues në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtimin dhe Arbitrazhin (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të ndonjë procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve në këtë marrëveshje ose çfarëdo kërkese nga çdo Palë kundër Palës tjetër që vjen në përputhje me to. Në të gjithë procedurën e arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze.

11.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditësh pasi homologët e vendimit do t'u jenë dorëzuar Palëve, vendimi nuk është në pajtueshmëri, çdo Palë mund të hyjë në gjykimin mbi të ose të fillojë një procedurë për të zbatuar vendimin pranë çdo gjykate të juridiksionit kompetent kundër Palës tjetër, mund të zbatojë një gjykim të tillë me ekzekutim ose mund të ndjekë çdo rregull tjetër të përshtatshëm kundër Palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

11.4 Secila Palë në këtë marrëveshje bie dakord se çdo gjykim i dhënë sipas kësaj marrëveshjeje kundër saj mund të ekzekutohet kundrejt fondeve të veta (aseteve) në çdo juridiksion.

Palët në këtë Marrëveshje heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo vërejtje që mund të kenë ndaj ndonjë padie, veprimi ose procedimi që vjen ose në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, sipas kësaj marrëveshjeje, paraqitur në çdo juridiksion në të cilin ata kanë fonde (asete), dhe në këtë mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga çdo pretendim që një padi e tillë, veprim ose procedim në çdo juridiksion të jetë paraqitur në ndonjë forum të papërshtatshëm.

11.5 Deri në masën që një Palë në këtë marrëveshje në çdo juridiksion mund të pretendojë për vete ose asetet e saj imunitet nga padia, ekzekutimi, ndalimi (qoftë në ndihmë ose ekzekutim, para vendimit, gjykimit ose ndryshe) ose procesi tjetër juridik ose në masën që në çdo juridiksion të tillë mund t'i atribuohet vetë ose aseteve të saj një imunitet i tillë (nëse apo jo i pretenduar), Pala e tillë në mënyrë të parevokueshme pajtohet që të mos pretendojë dhe në këtë mënyrë të parevokueshme heq dorë nga një imunitet i tillë.

Neni 12
**Koordinimi dhe njoftimet**

12.1 Koordinimi. Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë, si përfaqësuesi i autorizuar i Blerësit (përfaqësuesi i Blerësit) do të përfaqësojë Blerësin në të gjitha çështjet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe për të gjitha qëllimet dhe synimet, pa kufizim, më saktësisht:

i) të jetë dakord me Shitësin dhe të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve, detyrë e Blerësit në bazë të kësaj marrëveshjeje.

ii) të gjitha komunikimet e çdo lloji të caktuar nga Shitësi për përfaqësuesin e Blerësit do të konsiderohet se janë dhënë rregullisht për Blerësin;

iii) të gjitha komunikimet e marra për Shitësin nga përfaqësuesi i Blerësit do të konsiderohen se janë dhënë ose marrë rregullisht nga ana e Blerësit; dhe

iv) Përfaqësuesi i Blerësit në çdo kohë do të kryejë koordinimin dhe bashkëpunimin e duhur dhe efikas, dhe do të sigurojë që Blerësi dhe agjencia ekzekutive të kryejnë detyrat e tyre në këtë marrëveshje.

12.2 Njoftimet. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet sipas kësaj marrëveshjeje ose në lidhje me këtë do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se është dhënë rregullisht kur dërgohet me teleks, shërbimi korrier i regjistruar ose letër Palës, së cilës i është dhënë në adresën e kësaj Pale specifikuar më poshtë ose në adresën tjetër që kjo Palë ka caktuar duke njoftuar Palën, duke i dhënë një njoftim të tillë, kërkesë ose komunikim.

Për Blerësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 222 8405
Faks: +355 4 225 8494
E-mail: sekretariazv1@minfin.gov.al

Për agjencinë ekzekutive:
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Njësia e Menaxhimit të Projektit, rr. "Sami Frashëri", nr. 4
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 225 3345
Faks: +355 4 225 3345
E-mail: agaruli@abcom.al

Për Shitësin:
P.O. Box 5925, Jeddah-21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel.: +966 2 6361400
Faks: +966 2 6366871
E-mail: archives@isdb.org

Neni 13
**Të ndryshme**

13.1 Titujt në këtë marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk janë menduar, dhe nuk do të interpretohen për të ndryshuar, kufizuar ose zgjeruar në asnjë mënyrë objektin ose kuptimin e gjuhës të përmbajtur në këtë marrëveshje.

13.2 Përshkrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

13.3 Personi që nënshkruan këtë marrëveshje në emër të secilës palë përfaqëson në këtë mënyrë dhe garanton palën tjetër që ai ose ajo ka të drejtën dhe autoritetin e nevojshëm ligjor për të zbatuar këtë marrëveshje në emër të Palës dhe e lidh Palën me detyrimet e kësaj marrëveshjeje.

13.4 Kjo marrëveshje i lidh dhe i sjell dobi pasardhësve dhe të caktuarve përkatës të Palëve, me kusht që asnjëri prej tyre nuk mund të caktojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim të tjetrit.

13.5 Kjo marrëveshje është ekzekutuar në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat secila Palë do të marrë një origjinal.

13.6 Data e kësaj marrëveshjeje, për të gjitha qëllimet e kësaj marrëveshjeje, do të jetë ajo që jepet në parathënie.

[Fundi i neneve]

Faqe ekzekutimi

Në dëshmi të kësaj, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në lidhje me projektin e ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës (ALB-0035), për një shumë që nuk tejkalon 7.580.000.00 USD (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë), e barabartë afërsisht me 4,900,000.00 ID (katër milionë e nëntëqind mijë dinarë islamikë), në datën e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

_____

Emri:
Titulli:

PËR DHE NË EMËR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

_____

Emri:
Titulli:

ANEKSI I
PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Punimet që do të financohen nga IDB do të jenë pjesë e infrastrukturës së portit siç përshkruhet më poshtë:

i) Rrugët paraprake dhe të aksesit (lidhur me nënkomponentët sipas Istisna'a). Ky nënkomponent lidhet me shpenzimet e mobilizimit dhe të çmobilizimit dhe ndërtimin e një rruge hyrëse 600 m të gjatë në portin e peshkimit jashtë valëpritëses ekzistuese kryesore dhe vendosur në plazh.

ii) Bankinë mbështetëse. Lëviz përgjatë gjatësisë së basenit për 175 m, bankina në breg do të formojë rrënjën e kalatave. Pontonët do të jenë 2 m të gjerë me një lartësi mbi ujë prej 0.6 m dhe do të furnizohen me ujë të pijshëm përgjatë gjatësisë së basenit për 175 m, bankina në breg do të formojë rrënjën e kalatave. Pontonët do të jenë 2 m të gjerë me një lartësi mbi ujë prej 0.6 m dhe do të furnizohen me ujë të pijshëm.

iii) Kalatat. Për zonën e ankorimit do të ndërtohen tri kalata. Të tria kalatat do të jenë të forta dhe secila do të jetë 81 metër e gjatë.

iv) Ndërtesat e portit dhe subjektet tregtare. Ndërtesat e portit të peshkimit do të përbëhen nga:

- ndërtesa FMO, 500 $m^2$ mbi 2 kate;
- blloku i higjienës, 35 $m^2$ dhe nënstacioni 9 $m^2$;
- vendrojë, 3 $m^2$ dhe zyra e shitjes së karburantit 1.8 $m^2$ (kabina modulare).

v) Shërbimet do të përbëhen nga:

- instalimi i sistemit të furnizimit me ujë;
- instalimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza do të lidhet me sistemin komunal;
- ndërtimi i objekteve të furnizimit të karburantit;
- instalimi i telefonit, komunikimit detar VHF dhe shërbime të tjera.

ANEKSI II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i financimit suplementar të propozuar është që të sigurojë sektorin shqiptar të peshkimit në Durrës deri në vitin 2015 me një port të vendosur strategjik plotësisht operativ që siguron një strehë të sigurt, ku anijet e peshkimit mund të shkarkojnë ngarkesën e tyre, të marrin furnizime dhe të ankorojnë në mënyrë të sigurt kur nuk janë të angazhuar në operacionet e peshkimit.

Shtrirja e përgjithshme e projektit përfshin përbërësit e mëposhtëm:

A) Ndërtimi i objekteve të portit;

B) Shërbimet e konsulencës;

C) Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU);

D) Kontrolli financiar.

Kostoja totale e projektit, duke përfshirë financimin suplementar llogaritet në 18.43 milionë USD, i përbërë nga 10.86 milionë USD, në monedhën vendase dhe 7.57 milionë USD në valutë të huaj.

Plani i propozuar i financimit të projektit është paraqitur në tabelën më poshtë:

*milion US$*

| Përbërës | IDB Kredi | GoA | Total | IDB (%) | IDB Istisna'a | GoA | Total | IDB (%) | Grand Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A – Ndërtimi i objekteve të portit** | | | | | | | | | |
| A1 – Rruga Kryesore & Aksesit | 0.30 | 0.07 | 0.37 | 82 | 1.78 | 0.00 | 1.78 | 100 | 2.15 |
| A2 – Bonifikimi i tokës (1.8 ha) | 1.37 | 0.30 | 1.67 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 1.67 |
| A3 – Valëpritësi kryesor(800 m) | 4.26 | 0.93 | 5.19 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 5.19 |
| A4 – Valëpritësi i mbrojtur nga era (96 m) | 0.61 | 0.14 | 0.75 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.75 |
| A5 – Bankina në breg (175 m) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.76 | 0.00 | 0.76 | 100 | 0.76 |
| A6 – Kalatat (3) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 2.33 | 0.00 | 2.33 | 100 | 2.33 |
| A7 – Ndërtesat e portit & Subjektet tregtare | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.57 | 0.00 | 0.57 | 100 | 0.57 |
| A8 – Shërbime komunale | | | | | | | | | |
| i – Sistemi i furnizimit me ujë | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 1.02 | 0.00 | 1.02 | 100 | 1.02 |
| ii – Derdhja e ujrave të zeza | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.12 | 0.00 | 0.12 | 100 | 0.12 |
| iii – Furnizimi me karburant | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.01 | 0.00 | 0.01 | 100 | 0.01 |
| iv – Furnizimi me energji elektrike | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.00 | 0.32 | 0.32 | 0 | 0.32 |
| Ndërtimi nën-total i objekteve të portit | 6.54 | 1.44 | 7.98 | 82 | 6.59 | 0.32 | 6.91 | 95 | 14.89 |
| **B – Shërbimet e konsulencës** | | | | | | | | | |
| i – Projekt i detajuar i inxhinierisë | 0.17 | 0.00 | 0.17 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.17 |
| ii - Mbikëqyrja | 0.38 | 0.00 | 0.38 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.38 |
| Nën-totali i Shërbimeve të Konsulencës | 0.55 | 0.00 | 0.55 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.55 |
| **C – Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)** | | | | | | | | | |
| i - Pagat | 0.29 | 0.04 | 0.33 | 88 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.33 |
| ii – Kostua e Operimit | 0.18 | 0.00 | 0.18 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.18 |
| iii – Paisjet IT & mjetet 4WD | 0.01 | 0.00 | 0.01 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.01 |
| iv – Reparti fillestar & Vizita e Prezantimit | 0.02 | 0.00 | 0.02 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.02 |
| Nën-totali PMU | 0.50 | 0.04 | 0.54 | 93 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.54 |
| **D – Kontrolli Financiar** | 0.05 | 0.00 | 0.05 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.05 |
| Kostua bazë | 7.64 | 1.48 | 9.12 | 84 | 6.59 | 0.32 | 6.91 | 95 | 16.03 |
| Kontingjencat fizike(10%) | 0.76 | 0.15 | 0.91 | | 0.66 | 0.03 | 0.69 | | 1.60 |
| Kontingjencat e çmimit(5%) | 0.38 | 0.07 | 0.45 | | 0.33 | 0.02 | 0.35 | | 0.80 |
| **I gjithë totali** | 8.78 | 1.70 | 10.48 | 84 | 7.58 | 0.37 | 7.95 | 95 | 18.43 |

Shënim. Financimi i shitësit sipas shumës Istisna'a do të përdoret për të mbuluar koston totale të punimeve të përshkruara në aneksin I, të cilat janë të gjitha pjesë e komponentit ndërtimi i objekteve të portit. Komponentët e tjerë te projektit janë financuar në kuadër të kredisë aktive (ALB-0020), e cila do të mbulojë zërat e mbetur të ndërtimit të objekteve të portit, si dhe shërbimet e konsulencës, Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU) dhe kontrollin financiar.

## SHTOJCA III
## FORMULAR I OPINIONIT TË KËSHILLTARIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BLERËSIT

[Për t'u printuar në letër me kokë]

PËR: BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
P.O.Box: 5925
Jeddah 21.432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Teleks: 601.137 vazhdim i SJ
Kabllo: BANKISLAMI JEDDAH

OPINION LIGJOR
(Projekti i ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës)

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë (Blerësi), kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me marrëveshjen Istisna'a dhe marrëveshjen e Agjencisë datë __ . __ ._____G (marrëveshjet) që sigurohen për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës, Shqipëri (Projekti) nga ana e Bankës Islamike për Zhvillim (Shitësi) për Republikën e Shqipërisë (Blerësi), në shumën prej 7.580.000 US$ (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarë US), përafërsisht ekuivalente me 4.900.000 ID (katër milionë e nëntëqind mijë dinarë islamikë). Unë kam shqyrtuar origjinalet (ose kopjet) të certifikuara të marrëveshjes që emëron Blerësin si agjent i Shitësit dhe me pëlqimin e Shitësit për mbikëqyrjen e punimeve dhe shitjen e tyre te Blerësi dhe dokumenteve të tjera, të tilla që unë i kam konsideruar të nevojshme ose të përshtatshme si një bazë për mendimet e shprehura këtu.

Opinionet e shprehura këtu janë të kufizuara për pyetjet që rrjedhin sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe nënndarjeve të tyre politike, dhe unë nuk pretendoj për të shprehur një opinion mbi çdo çështje që rrjedh sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër.

Të gjithë termat e përcaktuar dhe përdorur në marrëveshje, por që nuk janë përcaktuar këtu kanë kuptimet që u jepen atyre në marrëveshje.

Në varësi të sa më sipër, unë jam i mendimit se:

a) Blerësi ka të drejtën dhe autoritetin për të zotëruar pasurinë e tij, për të kryer biznesin e tij si kryhet aktualisht dhe të përmbushë transaksionet e parashikuara në marrëveshje.

b) Blerësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin dhe dorëzimin e marrëveshjeve dhe të gjitha dokumenteve të tjera për t'u ekzekutuar dhe dorëzuar prej tij në lidhje me marrëveshjen, performancën e detyrimeve të tij, sipas marrëveshjeve dhe konsumimit të transaksioneve parashikuar në marrëveshje.

c) Marrëveshjet janë ekzekutuar në mënyrë të rregullt dhe dorëzuar nga ana e Blerësit dhe përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Blerësit të zbatueshme ndaj Blerësit në përputhje me afatet e tyre, objekt i paaftësisë paguese në fuqi, moratorium dhe ligje të ngjashme që ndikojnë në të drejtat e kreditorëve në përgjithësi.

d) Janë marrë ose kryer të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet e çfarëdolloji të nevojshme për të autorizuar ose të nevojshme për vlefshmërinë ose ekzekutimin e detyrimeve të parashikuara sipas marrëveshjeve, kundrejt Blerësit dhe janë të vlefshme dhe qëndrojnë në fuqi dhe efekt të plotë.

e) Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur dhe po vazhdon të përbëjë ose që me dhënien e njoftimit ose kalimit të kohës apo të dyja, do të përbëjë një mosplotësim sipas çdo marrëveshje ose dokumenti që dëshmon ndonjë detyrim të Blerësit dhe asnjë rast i tillë nuk do të ndodhë me kryerjen e çdo shpagimi sipas marrëveshjeve.

f) Nuk kërkohet asnjë pëlqim apo aprovim ose njoftim për çdo kreditor të Blerësit nga kushtet e çfarëdo marrëveshjeje ose dokumenti që dëshmon çdo detyrim të Blerësit për ekzekutimin ose ofrimin, ose në përmbushjen e detyrimeve të Blerësit, sipas marrëveshjeve ose konsumimit të transaksioneve të parashikuara në marrëveshjet dhe se, ofrimi i ekzekutimit, performanca dhe konsumi nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje, ose përbëjnë një mosplotësim, akti themelues apo aktet nënligjore të Blerësit ose ndonjë dokument marrëveshje, gjykim apo mënyrë e njohur për mua, apo ndonjë statut, rregull apo rregullore, të zbatueshme për Blerësin ose të ndonjë prej pasurive të tij.

g) Nuk ka veprime ose procedura në pritje ose për dijeninë time që kërcënojnë përcaktimin negativ nga të cilat mund të ketë një efekt negativ material mbi gjendjen financiare të Blerësit ose të pengojnë aftësinë e Blerësit për të kryer detyrimet e tij sipas, apo të ndikojnë në vlefshmërinë ose

ekzekutimin e marrëveshjeve.

h) Blerësi gëzon pronësi pa barra mbi pasuritë e tij dhe pa garancitë e tjera, si dhe detyrimet e tij sipas rendit të marrëveshjes së paku *pari passu* me të gjitha detyrimet e tij të tjera të pasigurta.

i) Ekzekutimi dhe dorëzimi i marrëveshjeve nuk është subjekt i ndonjë takse, detyre, tarife apo pagese tjetër, duke përfshirë, pa kufizim, çdo regjistrim ose taksë të transferimit, pullë takse apo vënie takse të ngjashme, vendosur nga ose brenda Republikës së Shqipërisë ose çdo nënndarje politike apo autoritet tatimi.

j) Në masën e plotë të lejuar nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, Blerësi heq imunitetin e tij në bazë të sovranitetit në lidhje me çdo veprim ose procedim që lidhet në çdo mënyrë me marrëveshjet që mund të paraqiten në gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

k) Në çdo rast, huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, për sa i përket ekzekutimit, në lidhje me:

"Kushtet paraprake aktuale ose të ardhshme të misionit" siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruara në vitin 1961, "kushtet paraprake aktuale ose të ardhshme konsullore" të përcaktuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore nënshkruar në 1963 ose përdorur ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose ndonjë agjenci në dobi të saj;

Çdo pasuri e paluajtshme, e cila bie nën dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit";

Çdo fond monetar dhe/ose shumë që ka qenë dhe është paguar në kohën e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve, që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventës dhe/ose marrëveshjeve nënshkruar nga ajo.

l) Ekzekutimi dhe dorëzimi i marrëveshjeve nga Blerësi dhe përmbushja e detyrimeve të tij përbëjnë transaksionet tregtare.

m) Zgjedhja nga Palët për marrëveshjet e parimeve të Sheriatit Islamik, si ligj drejtues është e ligjshme, e vlefshme dhe detyruese.

n) Nuk është e nevojshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria apo pranueshmëria e provave pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë të marrëveshjeve që ata kanë ngritur, depozituar, regjistruar ose paraqitur me çdo gjykatë ose agjenci qeveritare të ose në Republikën e Shqipërisë ose vulosur me çdo vulë ose taksë të ngjashme transaksioni.

o) Sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nuk është e nevojshme t'i krijohet mundësia Shitësit për të zbatuar të drejtat e tij, sipas marrëveshjeve ose për shkak të zbatimit të marrëveshjeve ose kryerjes nga Shitësi të detyrimeve të tij që Shitësi duhet të jetë i licencuar, i kualifikuar ose të ketë të drejtën për të kryer biznes në Republikën e Shqipërisë.

p) Shitësi nuk do të konsiderohet të jetë rezident, banues për të kryer biznes apo t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të ekzekutimit performancës dhe/ose zbatimit të marrëveshjeve, ndërtimit të punimeve nga Shitësi dhe shitja e tyre te Blerësi, në përputhje me marrëveshjet, dhe nuk do të vendoset asnjë taksë në burim apo shuma të tjera të marra ndryshe nga Shitësi sipas marrëveshjeve.

Përveç, nëse dhe derisa unë t'i japë Shitësit njoftim për çdo ndryshim në këtë opinion para pagesës së fondeve sipas marrëveshjes, ju dhe këshilltari juaj mund të mbështeteni në këtë opinion në çdo kohë nga data e kësaj marrëveshje dhe duke përfshirë pagesa të tilla, ashtu sikurse ky opinion është datuar në, si dhe në këtë ditë dhe është dorëzuar në një orë të tillë.

Me sinqeritet,

_____
Emri:
MINISTRI I DREJTËSISË

Projekti nr. ALB-0035

**MARRËVESHJE E AGJENCISË ISTISNA'A**
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM LIDHUR ME PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT NË DURRËS, SHQIPËRI

Kjo marrëveshje është lidhur më ____/____/ ____H (që korrespondon me ____/ ____/___G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë si agjent (në vijim referuar si "Blerësi") dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim referuar si "Shitësi").

Blerësi dhe Shitësi referohen kolektivisht si "Palët" dhe individualisht si "Pala".

Meqenëse:

A) Blerësi i ka kërkuar Shitësit të financojë ndërtimin e punimeve siç përshkruhet në aneksin I (në vijim referuar si "punimet") për projektin e ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës, siç përshkruhet në shtojcën II (në vijim referuar si "projekti");

B) Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të Shitësit ka miratuar në datë 24/08/1433H (14/07/2012G) një shumë që nuk tejkalon 7.580.000 USD (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë), përafërsisht ekuivalente me 4,900,000 ID (katër milionë e nëntëqind mijë dinarë islamikë), për ndërtimin e punimeve për projektin përmes Istisna'a.

C) Shitësi ka rënë dakord në përputhje me marrëveshjen (në vijim referuar si "Marrëveshja Istisna'a) për të ndërtuar për blerësin punimet, në cilësinë e tij si blerës.

Në vijim, Shitësi dhe Blerësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1
**Përkufizimet - interpretimi**

1.1 Në këtë marrëveshje, përveç rasteve kur nga konteksti rezulton ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që paraqitet në krah të secilit prej tyre si vijon:

"Shuma e miratuar", shuma e specifikuar më lart në përshkrimin B.

"Punimet", punimet e përshkruara në aneksin I.

"Kostoja kapitale", kostoja totale e ndërtimit të punimeve, e cila do të përfshijë çmimin e kontratës dhe çdo kosto ose shpenzim tjetër, të shkaktuar nga Shitësi në lidhje me ndërtimin e punimeve plus një normë e lëvizshme e ngritjes së çmimit e Libor USD 6-mujore plus 135 pikë bazë në vit që aplikohen për çdo disbursim gjatë periudhës së drejtimit.

"Konsulenti", firma e konsulencës ose konsulencë individuale e caktuar në përputhje me nenin 4.

"Kontrata", kontrata për ndërtimin e punimeve të përfunduara në emër të Shitësit nga Blerësi përmes agjencisë zbatuese me kontraktuesin.

"Çmimi i kontratës", shuma që i paguhet kontraktuesit për ndërtimin e punimeve.

"Kontraktuesi", kontraktuesi që ngarkohet për ndërtimin e punimeve.

"Data e disbursimit të parë", data në të cilën Shitësi bën disbursimin e parë sipas kontratës, cilado që është më e herët.

"Disbursimi", pagesa aktuale e çdo pjese të shumës së miratuar në bazë të kësaj marrëveshjeje.

"Data e efektivitetit", data në të cilën shitësi deklaron efektive këtë marrëveshje ose marrëveshjen Istisna'a (si mund të jetë rasti) në përputhje me nenin 14.

"Agjencia zbatuese", Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Republika e Shqipërisë.

"Certifikata përfundimtare e pranimit", certifikata e lëshuar nga konsulenti, në përputhje me kushtet e kontratës, e cila tregon se ndërtimi i punimeve ka përfunduar me sukses nga ana e kontraktuesit.

"Periudha e drejtimit", periudha që fillon në Datën e Disbursimit të Parë dhe mbaron pas 3 (tri) vitesh.

"Marrëveshja e kredisë", marrëveshja e kredisë e nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shitësit më 06/11/1427H që korrespondon më 27/11/2006G, për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës, Republika e Shqipërisë.

"Certifikata paraprake e pranimit", certifikata e lëshuar nga konsulenti, në përputhje me kushtet e kontratës, e cila tregon se ndërtimi i punimeve ka përfunduar me sukses nga ana e kontraktuesit.

"Projekti" ka kuptimin e përcaktuar në përshkrimin A si më sipër.

"Praktikat e sanksionueshme" secila nga praktikat e korruptuara, praktika shtrënguese, praktikat e fshehta, mashtruese ose praktikat penguese:

a) "Praktika e korruptuar" do të thotë ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në veprimet e një Pale tjetër;

b) "Praktika shtrënguese" nënkupton çdo veprim ose mosveprim që cenon, dëmton, kërcënon për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo Palë ose pronë e palës për të ndikuar në mënyrë të paligjshme veprimet e një Pale.

c) "Praktika e fshehtë" do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e hartuar për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të paligjshme në veprimet e një Pale tjetër.

d) "Praktika mashtruese" nënkupton çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë një shtrembërim, që mashtron me dashje ose nga pakujdesia, ose tenton të mashtrojë, një Palë për të marrë një përfitim financiar ose tjetër, ose për të shmangur një detyrim.

e) "Praktika penguese" do të thotë:

i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose marrjen e deklaratave të rreme nga hetuesit, në mënyrë që të pengohet materialisht hetimi i Shitësit në akuzat për një praktikë të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë dhe/ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për të parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimi; ose

ii) veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të Shitësit në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin e Shitësit në akuzat e një praktike të korruptuar, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

"Taksat", çdo taksë, vënie taksash, tatim, detyrim ose detyrime të tjera të kësaj natyre (duke përfshirë pa kufizim çdo gjobë të pagueshme në lidhje me çfarëdo mospagimi ose vonese në pagesën e secilës prej tyre).

"Dollari US/USD" monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.2 Në këtë marrëveshje:

a) Vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që paraqesin personat përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referencat në një aneks të caktuar, shtojca, nen ose seksion është një referencë për atë aneks shtojcë, nen ose seksion i kësaj marrëveshje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në marrëveshjen Istisna'a dhe jo të përkufizuara këtu, do të kenë të njëjtin kuptim që i është dhënë në marrëveshjen Istisna'a.

Neni 2
**Agjencia**

Shitësi emëron Blerësin si agjent të tij për të përfunduar kontratën me kontraktuesin dhe të mbikëqyrë ndërtimin e punimeve dhe Blerësi bie dakord me këtë emërim.

Neni 3
**Prokurimi i mallrave dhe i shërbimeve**

3.1 Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të financuara nga Shitësi është bërë në përputhje me udhëzimet e prokurimit të Shitësit dhe si përcaktohet në marrëveshjen e kredisë. Prandaj:

i) Conseil, Ingénierie et Développement (CID). Marok është përzgjedhur si konsulent nga një listë e konsulentëve të kufizuar në vendet anëtare të Shitësit, për të ndërmarrë hartimin e detajuar të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve.

ii) Strabag Omani LLC, Sulltanati i Omanit është përzgjedhur si kontraktuesi, përmes një procesi konkurrues tenderimi të kufizuar në vendet anëtare të Shitësit për ndërtimin e infrastrukturës së portit.

3.2 Blerësi do të sigurojë që të përfshihen dispozitat kundër korrupsionit dhe kundër mashtrimit, të pranueshme për Shitësin në të gjitha kontratat, duke përfshirë dispozitat që specifikojnë të drejtën e Shitësit, për të kontrolluar dhe shqyrtuar të dhënat dhe llogaritë e agjencive të ekzekutimit dhe të zbatimit dhe të gjithë kontraktuesit, furnizuesit, konsulentët dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve që lidhen me projektin.

Neni 4
**Zgjedhja e kontraktuesit dhe konsulenti**

4.1 Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, në emër të Shitësit, do të negociojë dhe do të lidhë një kontratë me subjektin kontraktues si vijon:

i) Termat dhe kushtet e kontratës do të jenë rënë dakord midis Shitësit dhe Blerësit;

ii) Çmimi i kontratës nuk duhet të tejkalojë shumën e marrëveshjes së kredisë prej 6.13 milionë ID (gjashtë milionë e njëqind e tridhjetë mijë dinarësh islamikë) plus shumën e miratuar prej 7.580.000 USD (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarësh amerikanë);

iii) Periudha e përfundimit të ndërtimit të punimeve sipas kontratës nuk duhet të tejkalojë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë;

iv) Specifikimet e punimeve sipas kontratës duhet të jenë si ato të përshkruara shkurtimisht në aneksin I dhe të detajuara në kontratë;

v) Pas përfundimit, punimet do të merren nën kontroll të drejtpërdrejtë nga Blerësi;

vi) Miratimi me shkrim i Shitësit për termat dhe kushtet e kontratës së negociuar, do të merren para përfundimit të kontratës nga ana e Blerësit;

vii) Kontrata do të parashikojë që kontraktuesi të sigurojë një sigurim nga të gjitha rreziqet e kontraktuesit, si ndodh zakonisht në tregti, dhe të ardhurat e sigurimit do t'i paguhen Shitësit në dollarë amerikanë ose në ndonjë valutë tjetër të pranueshme.

4.2 Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, në emër të Shitësit, do të negociojë dhe lidhë një kontratë me subjektin konsulent për sa vijon:

i) Konsulenti do të jetë përgjegjës për të verifikuar të gjitha kërkesat e disbursimit të bëra nga shitësi. Ky konsulent do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për të koordinuar të gjitha aktivitetet, të sigurojë raporte të rregullta të ecurisë, të sigurojë që të gjitha politikat dhe procedurat e Shitësit janë ndjekur në mënyrë rigoroze gjatë zbatimit të punimeve;

ii) Për termat e referencës së kontratës së konsulentit do të bihet dakord me shkrim midis Blerësit dhe Shitësit.

iii) Blerësi do të shoqërojë Shitësin në negociata me konsulentin e përzgjedhur; rezultati i të cilave do t'i nënshtrohet miratimit përfundimit të Shitësit dhe Blerësit.

Neni 5
**Menaxhimi i kontratave**

5.1 Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, ndërmerr se në menaxhimin e tij të kontratës, ai do të ushtrojë standardin më të lartë të përkushtimit dhe të kujdesit në monitorimin e performancës së përpiktë dhe të saktë nga kontraktuesi të detyrimeve të tij sipas kontratës, me qëllim për të siguruar që asetet do të ndërtohen në përputhje me specifikimet brenda kohës dhe me çmimin e përcaktuar në kontratë.

5.2 Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Shitësit, nuk do të bëjë ndonjë ndryshim ose modifikime në kontratë, të cilat:

i) mund të rezultojë në një rritje të çmimit të kontratës; ose

ii) mund të rezultojë në një zgjatje të datës së përfundimit; ose

iii) mund të rezultojë në një ndryshim të specifikimeve; ose

iv) mund të mos jenë në përputhje me praktikë të mirë të zakonshme.

5.3 Pa paragjykuar përgjithësinë e nenit 5.1, Blerësi, përfaqësuar nga agjencia ekzekutive, do të jetë i detyruar që:

i) të këshillojë Shitësin, sa më shpejt që është e mundur, për çdo vonesë ose vonesë të parashikuar në përfundimin e ndërtimit të punimeve me detaje të plota të tyre;

ii) të merret me të gjitha çështjet rregullatore dhe administrative që lidhen me ndërtimin e punimeve në përputhje me ligjet përkatëse në Republikën e Shqipërisë;

iii) të nënshkruajë certifikatën paraprake të pranimit dhe certifikatën përfundimtare të pranimit, në qoftë se ai është i kënaqur që punimet në fazën përkatëse janë zbatuar në përputhje me kontratën, duke përfshirë specifikimet.

5.4 Nëse në shkelje të nenit 5, Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, jep udhëzime për kontraktuesin, si rezultat i të cilave ka një rritje në çmimin e kontratës apo Shitësi bëhet përgjegjës për çdo Palë për çdo kërkesë, humbje, dëm ose shpenzim, atëherë Blerësi bie dakord të mbartë rritjen e çmimit të kontratës ose, sipas rastit mund të jetë, për të dëmshpërblyer Shitësin për çdo kërkesë, dëmtim, humbje ose shpenzim të tillë.

5.5 Është rënë dakord që Blerësi i përfaqësuar nga agjencia zbatuese, do të sigurojë një numër të personelit të tij, si do të jetë e nevojshme për të kryer detyrat e tij, sipas kësaj marrëveshjeje dhe sipas kontratës.

5.6 Blerësi nuk ka të drejtë për ndonjë shpërblim ose pengesa të tjera nga Shitësi në lidhje me ose që rrjedhin nga emërimi i Blerësit si mbikëqyrës i Shitësit sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 6
**Disbursimi i shumës së miratuar**

6.1 Shitësi do të disbursojë shumën e miratuar, në mënyrën e përcaktuar në kontratë dhe në përputhje me procedurat e disbursimit të Shitësit.

6.2 Data e kërkimit të disbursimit të parë. Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshme ose në një datë të mëvonshme që do të bihet dakord ndërmjet Blerësit dhe Shitësit, Blerësi përfaqësuar nga agjencia zbatuese nuk ka paraqitur një kërkesë te Shitësi për të bërë disburismin e parë, Shitësi mund ta përfundojë këtë marrëveshje për shkak të tyre, pasi ka njoftuar Blerësin.

6.3 Data e mbylljes së disbursimit. 31.12.2015G ose në një datë të mëvonshme, siç do të bihet dakord ndërmjet Blerësit dhe Shitësit është data e mbylljes së tërheqjes sipas kësaj marrëveshjeje.

6.4 Pa paragjykuar përgjithësinë e nenit 6.1, Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, kur të paraqesë kërkesën për disbursimin e parë sipas kontratës, do të sigurojë një kopje të nënshkruar të kontratës (nëse nuk paraqitet më herët) dhe kopje të policës së sigurimit.

6.5 Konsulenti do të verifikojë të gjitha kërkesat e disbursimit të bëra nga Shitësi.

6.6 Shitësi nuk do të jetë i detyruar për të kryer ndonjë disbursim, nëse kërkesa për disbursim nuk është në përputhje me këtë marrëveshje ose nëse dokumentet e paraqitura nga ana e Blerësit, përfaqësuar nga agjencia ekzekutive, janë të paplota ose të dëmtuara. Blerësi do të jetë përgjegjës për çdo vonesë në livrimin e disbursimit, nëse një vonesë e tillë është për shkak të kërkesës që nuk është në përputhje me këtë marrëveshje ose për shkak të pamjaftueshmërisë apo mospërputhjes në dokumentet e kërkuara.

Neni 7

**Marrja në dorëzim e punimeve**

7.1 Është rënë dakord që kontrata do të sigurojë marrjen në dorëzim të punimeve pas përfundimit, drejtpërdrejt nga ana e Blerësit të përfaqësuar nga agjencia zbatuese. Është rënë dakord, gjithashtu, se në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës për Blerësin, për ndonjë humbje që rezulton nga ndonjë vonesë në marrjen në dorëzim të punimeve.

7.2 Për shmangien e dyshimit është rënë dakord se në qoftë se Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, refuzon të marrë në dorëzim punimet nga kontraktuesi për çfarëdo arsye, Blerësi do të dëmshpërblejë Shitësin për çdo kosto, shpenzim ose humbje që rezulton nga kjo.

Neni 8

**Pezullimi dhe ndërprerja**

8.1 Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e vlefshme e kësaj marrëveshjeje, Shitësi me njoftim për Blerësin mund të anulojë shumën e miratuar, përveç nëse ajo përmbushet duke u justifikuar nga Blerësi për një vonesë të tillë.

8.2 Në rast se kontraktuesi nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kontratës dhe Blerësi, në konsultim me Shitësin, zgjidh kontratën në përputhje me kushtet e saj, një përfundim i tillë do të veprojë pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga përfundimi si një anulim i çdo shume që ka ngelur e padisbursuar nga shuma e miratuar, përveç nëse Shitësi bie dakord ndryshe.

8.3 Para nënshkrimit të Kontratës, Shitësi duke njoftuar Blerësin, mund të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje në ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Mund të jetë krijuar një situatë e jashtëzakonshme, e cila:

i) sipas mendimit të arsyeshëm të Shitësit, do ta bëjë atë të pamundur që Blerësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje; ose

ii) do të pengojë arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo marrëveshje.

b) Një përfaqësim i kryer nga ana e Blerësit ose ndonjë deklaratë e dhënë dhe që ka për qëllim të mbështetet nga Shitësi në përpunimin e projektit për miratim ose për të lidhur këtë marrëveshje, do të ketë qenë i paplotë ose i pasaktë në çdo aspekt material.

8.4 Shitësi mund të përfundojë ose të pezullojë këtë marrëveshje nëse Shitësi përcakton se:

i) Blerësi është në shkelje të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

ii) në lidhje me zbatimin e ndonjë kontrate për t'u financuar plotësisht ose pjesërisht nga fondet e financimit, çdo person ose entitet është angazhuar në çdo praktikë të sanksionueshme dhe Blerësi nuk ka marrë masa në kohë të përshtatshme dhe të kënaqshme për Shitësin, për të korrigjuar situatën apo për të adresuar praktika të tilla kur ato ndodhin.

8.5 Çdo pezullim i marrëveshjes ose i shumës së miratuar do të vazhdojë derisa ngjarja apo ngjarjet, të cilat i dhanë nismën një pezullimi të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Shitësi do të ketë njoftuar Blerësin dhe është rikthyer me ndërmarrrjen e Shitësit, për të siguruar punimet, cilado që është më herët, me kusht, që në rast të ndonjë njoftimi të tillë të rikthimit, ndërmarrja për ndërtimin e punimeve do të rikthehet vetëm në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në njoftimin e tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose nuk do të pengojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose rregullim të Shitësit, në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër ose të mëvonshme përshkruar në këtë nen.

8.6 Kjo marrëveshje do të përfundojë automatikisht pas përfundimit të Marrëveshjes Istisna'a ose anulimit të shumës së miratuar sipas Marrëveshjes Istisna'a.

8.7 Nëse kjo marrëveshje përfundon për shkak të mospërmbushjes nga ana e Blerësit të detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje dhe/ose mosarritjes për të siguruar dorëzimin e punimeve, Blerësi do të dëmshpërblejë Shitësin me një shumë të barabartë me shpenzimet kapitale të përcaktuara në datën e përfundimit.

8.8 Pas dorëzimit të punimeve dhe lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit kjo marrëveshje do të ndërpritet dhe do të shkarkohet detyrimi i Blerësit sipas saj.

Neni 9
**Përfaqësimi dhe garancitë**

Blerësi paraqet dhe garanton se:

i) ai ka të drejtën për të lidhur këtë marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij në këtë marrëveshjeje dhe të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje dhe performanca nga Blerësi e detyrimeve të tij është marrë në mënyrë të rregullt;

ii) detyrimet e shprehura për t'u marrë nga ana e Blerësit në këtë marrëveshje janë detyrime ligjore dhe të vlefshme të detyrueshme për Blerësin në përputhje me kushtet;

iii) zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe përmbushja e detyrimeve të Blerësit nuk përbëjnë dhe nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje të ndonjë marrëveshjeje, traktati apo ligji;

iv) të gjitha aktet, kushtet dhe sendet (duke përfshirë shkëmbimin e pëlqimeve të kontrollit) të kërkuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, janë përmbushur dhe kryer në mënyrë që:

a) të mundësojnë Blerësin për të lidhur këtë marrëveshje në mënyrë të ligjshme dhe për të kryer detyrimet e shprehura marrë nga ai;

b) të sigurojë që detyrimet e shprehura marrë nga ai në këtë marrëveshje janë ligjore, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

c) për të bërë këtë marrëveshje të pranueshme si dëshmi në Republikën e Shqipërisë pa hapa të mëtejshëm ose formalitetet të jenë bërë, të jenë plotësuar dhe të jenë kryer në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Neni 10
**Rastet e mospërmbushjes**

10.1 Nëse një nga rastet e përcaktuara në këtë nen do të ketë ndodhur dhe vazhdon të ndodhë, atëherë Shitësi duke njoftuar Blerësin, mund të deklarojë që të paguhet menjëherë, i gjithë ose një pjesë e çmimit të shitjes (çdo gjë në këtë marrëveshje, pavarësisht) pa asnjë njoftim të mëtejshëm:

a) Mosplotësimi duhet të ketë ndodhur në pagesën e ndonjë prej kësteve të çmimit të shitjes dhe një mosplotësim i tillë ka vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

b) Mosplotësim, përveç nëse mosplotësimi i specifikuar në nenin 10.1 (a), duhet të ketë ndodhur në kryerjen e ndonjë detyrimi të Blerësit në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe një mosplotësim i tillë vazhdon për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

c) Çdo përfaqësim ose garanci konfirmuar apo kryer nga ana e Blerësit në lidhje me ekzekutimin dhe dorëzimin e kësaj marrëveshjeje ose në lidhje me ndonjë kërkesë për pagesë sipas kësaj marrëveshjeje, mendohet se ka qenë e pasaktë në çfarëdo aspekti material dhe vazhdon të jetë e gabuar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit që i është dhënë Blerësit nga Shitësi.

d) Blerësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet e tij ashtu si duhet ose përndryshe ka falimentuar; ose çdo mbajtës i garancisë do të ketë marrë ligjërisht zotërim ose do të jetë caktuar një marrës ose administrues i besuar për të gjithë ose ndonjë pjesë të sipërmarrjes ose aseteve të Blerësit; ose një fatkeqësi ose ekzekutim (ose proces i ngjashëm) është vënë, zbatohet ose lëshohet kundër ndonjë pasurie të luajtshme ose pronë të Blerësit dhe një fatkeqësi e tillë apo ekzekutim nuk do të jetë paguar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh; apo është dhënë një porosi ose ka kaluar një zgjidhje efektive apo procedura të ngjashme, ndërmarrë për likuidimin e Blerësit, falimentimi apo shpërbërja; apo çdo ngjarje tjetër ndodhur në bazë të një ligji në fuqi do të ketë një efekt analog me secilën nga ngjarjet e renditura më sipër në këtë paragraf.

e) Ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme.

10.2 Nëse ndodh ndonjë rast mospërmbushjeje ose çfarëdo ngjarje e cila me kalimin e kohës ose njoftim dhe me kalimin e kohës kthehet në një rast mospërmbushjeje, Blerësi do të njoftojë menjëherë Shitësin me teleks ose faks, duke specifikuar natyrën e rastit të tillë të mospërmbushjes ose rast të tillë dhe çdo hap që Blerësi merr për të korrigjuar një gjë të tillë.

10.3 Asnjë vazhdim marrëveshjeje, dhe asnjë vonesë në ushtrimin, ose mosveprim për të ushtruar, çdo të drejtë, kompetencë apo rregullim që rrjedh për Shitësin mbi çdo mosplotësim, sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje tjetër do të pengojë një të drejtë të tillë, kompetencë, apo rregullim ose të interpretohet që të jetë një heqje dore prej tyre ose pranim i heshtur; as veprimi i Shitësit në lidhje me ndonjë mungesë të tillë, apo ndonjë pranim i heshtur nga ai aty, nuk do të ndikojë apo pengojë asnjë të drejtë, kompetencë ose rregullim të Shitësit në lidhje me ndonjë mosplotësim tjetër.

Neni 11
**Dëmshpërblimi**

11.1 Blerësi merr përsipër të dëmshpërblejë Shitësin, mbi një bazë neto pas tatimit (me normat e zbatueshme vendase dhe të huaja tatimore), dhe pajtohet për të mbrojtur, ruajtur dhe për të mbajtur të padëmshëm Shitësin nga çdo dhe të gjitha detyrimet, taksat, përgjegjësitë, humbjet, dëmtimet, dënimet, kërkesat, veprimet, gjykimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat ligjore të arsyeshme dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifa ligjore të tilla dhe shpenzime të shkaktuara në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje), të çdo lloji dhe natyre të vendosur, të shkaktuar nga, ose pohuar kundër Shitësit që rrjedhin nga:

a) pronësia, posedimi, përdorimi, dokumentacioni, heqja, kthimi, apo zbatime ose dispozita të tjera sipas Kontratës ose Marrëveshjes së Konsulencës, duke përfshirë se këto mund të lindin nga:

i) çdo humbje ose dëmtim i çdo prone apo vdekje ose plagosje e çdo personi;

ii) patentë ose defekte të fshehta në punime;

iii) çdo pretendim i bazuar në përgjegjësinë e saktë në delikti ose ndryshe;

iv) çdo kërkesë bazuar në shkeljen e patentës, markës tregtare ose në të drejtën e autorit;

v) çdo kërkesë bazuar në përgjegjësinë që rrjedh sipas ligjeve të zbatueshme ose miratimeve mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me pronësinë e punimeve ose të truallit, mbi të cilin është ndërtuar;

vii) çdo pretendim apo mosmarrëveshje në lidhje me kontratën ose ndonjë letër krediti vendosur në pajtim me to.

b) shfaqja e ndonjë mosplotësimi ose ndonjë mospërmbushjeje tjetër nga ana e Blerësit ose kontraktuesit për të kryer ose të pajtuar me çdo kusht të kësaj marrëveshje, ose çdo dokument, marrëveshje, ose kontratë të lidhur në lidhje me këtë dokument, ose ndryshe në raport me punimet, por duke përjashtuar çdo pretendim të bazuar mbi çdo dështim nga ana e Shitësit për të përmbushur detyrimet e tij, sipas kësaj marrëveshjeje ose çdo dokument, marrëveshje apo kontratë të lidhur nga Shitësi në lidhje me këtë ose ndryshe në raport me punimet;

c) çdo kërkesë, pengesë, interesat e sigurisë dhe pengesë si garanci ose proceset ligjore lidhur me pronësinë ose interesin në punime apo tokën, mbi të cilën është ndërtuar.

11.2 Blerësi do ta njoftojë menjëherë Shitësin për shfaqjen e ndonjë kushti të njohur për Blerësin, si pasojë e të cilit Shitësi ka apo ka të ngjarë në mënyrë të arsyeshme të drejtën për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi dhënë në nenin 11.1 do të zbatohet posaçërisht dhe do të përfshijë kërkesat ose veprimet e paraqitura nga ose në emër të punonjësve të Blerësit dhe Blerësi do të heqë dorë shprehimisht, ashtu si kundër Shitësit, nga çdo imunitet për të cilin Blerësi përndryshe mund të ketë të drejtë në bazë të ndonjë ligji të zbatueshëm. Me kërkesë të Shitësit (por në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga një kërkesë e tillë), Blerësi duhet të rimbursojë menjëherë Shitësin për shumat e shpenzuara nga ai në lidhje me ndonjë nga sa më sipër ose të paguajë drejtpërdrejt shuma të tilla. Blerësi do të funksionojë me të drejtat e Shitësit në çdo çështje në lidhje me të cilat Blerësi ka rimbursuar si duhet Shitësin për shumat e shpenzuara prej tij, ose ka paguar drejtpërdrejt shuma të tilla në pajtim me nenin 9. Në rast se ndonjë veprim ose procedim është paraqitur kundër Shitësit në lidhje me ndonjë pretendim të dëmshpërblyer, pas marrjes së njoftimit të fillimit të një veprimi ose procedimi të tillë, Shitësi do të njoftojë Blerësin e tij, duke bashkëngjitur një kopje të të gjitha dokumenteve dorëzuar Shitësit. Me kërkesë të Shitësit, Blerësi mund të rezistojë dhe të mbrojë një veprim të tillë apo akte në ngarkim të Blerësit ose të shkaktojë të njëjtën gjë për të rezistuar ose për të mbrojtur nga avokati i zgjedhur nga ana e Blerësit në mënyrë të arsyeshme dhe me dëshirën e Shitësit. Në rast të ndonjë dështimi nga ana e Blerësit për ta kryer sa më lart, Blerësi do të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit) të shkaktuara nga Shitësi në lidhje me këtë veprim apo procedim.

Neni 12
**Raportet**

Blerësi, përfaqësuar nga agjencia zbatuese, merr përsipër t'i paraqesë raportet e mëposhtme shitësit:

i) brenda 3 (tre) muajsh pas datës së hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe më pas çdo tre muaj, një raport mbi progresin dhe zbatimin e kontratës, në mënyrë të tillë, ashtu si shitësi mund të specifikojë herë pas here;

ii) menjëherë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, por jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të certifikatës së tillë, të paraqesë një raport të plotë në fushën e tillë dhe në detaje, të tilla si Shitësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, mbi ndërtimin e punimeve dhe operimin fillestar të projektit;

iii) një raport vjetor auditimi nga auditori financiar i projektit. Ky raport do të jepet gjatë periudhës së drejtimit dhe periudhës së pagesës së çmimit të shitjes sipas kësaj marrëveshjeje; dhe

iv) çdo raport tjetër ose informacion që Shitësi mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Neni 13
**Heqja dorë**

Dështimi i Shitësit për të ushtruar ose pohuar ndonjë nga të drejtat e tij, sipas kësaj marrëveshjeje ose vonesë e tij në të njëjtën ose dështimi i tij për të ushtruar ose pohuar çdo rregull

që mund të ketë kundër Blerësit ose vonesës së tij në të njëjtën gjë, nuk do të paragjykojë një të drejtë të tillë apo rregullim dhe nuk duhet të interpretohet si një heqje dorë nga një e drejtë e tillë ose rregullim.

Neni 14
**Data e efektivitetit**

Kjo marrëveshje shpallet efektive që nga shpallja efektive e marrëveshjes Istisna'a.

Neni 15
**Ligji i zbatueshëm - zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

15.1 Kjo marrëveshje do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islam të shqiptuara nga ana e Akademisë Islame Fiqh, të shpallura në Standardet e Sheriatit publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI), dhe interpretohet nga Komiteti i Sheriatit të Shitësit.

15.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë marrëveshje dhe çdo pretendim nga çdo Palë për Palën tjetër që lind në këtë marrëveshje, i cili nuk mund të zgjidhet me marrëveshje të palëve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e njoftimit nga njëra Palë te tjetra, do të dorëzohet para një paneli arbitrazhi për vendim përfundimtar dhe detyrues në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtimin dhe Arbitrazhin (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të ndonjë procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve në këtë marrëveshje ose çfarëdo kërkese nga çdo Palë kundër Palës tjetër që vjen në përputhje me to. Në të gjithë procedurën e arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze.

15.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditësh, pasi homologët e vendimit do t'u jenë dorëzuar Palëve, vendimi nuk është në pajtueshmëri, çdo Palë mund të hyjë në gjykimin mbi të, ose të fillojë një procedurë për të zbatuar vendimin pranë çdo gjykate të juridiksionit kompetent kundër Palës tjetër, mund të zbatojë një gjykim të tillë me ekzekutim ose mund të ndjekë çdo rregull tjetër të përshtatshëm kundër Palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

15.4 Secila Palë në këtë marrëveshje bie dakord se çdo gjykim i dhënë sipas kësaj marrëveshje, kundër saj mund të ekzekutohet kundrejt fondeve të veta (aseteve) në çdo juridiksion. Palët në këtë marrëveshje heqin dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo vërejtje që mund të kenë ndaj ndonjë padie, veprimi ose procedimi që vjen ose në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi sipas kësaj marrëveshjeje, paraqitur në çdo juridiksion në të cilin ata kanë fonde (asete), dhe në këtë mënyrë të parevokueshme heqin dorë nga çdo pretendim që një padi e tillë, veprim ose procedim në çdo juridiksion të jetë paraqitur në ndonjë forum të papërshtatshëm.

15.5 Deri në masën që një Palë në këtë marrëveshje në çdo juridiksion mund të pretendojë për vete ose asetet e saj imunitet nga padia, ekzekutimi, ndalimi (qoftë në ndihmë ose ekzekutim, para vendimit, gjykimit ose ndryshe) ose procesi tjetër juridik ose në masën që në çdo juridiksion të tillë mund t'i atribuohet vetë ose aseteve të saj një imunitet i tillë (nëse apo jo i pretenduar), Pala e tillë në mënyrë të parevokueshme pajtohet që të mos pretendojë dhe në këtë mënyrë të parevokueshme heq dorë nga një imunitet i tillë.

Neni 16
**Koordinimi dhe njoftimet**

16.1 Koordinimi. Ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë, si përfaqësuesi i autorizuar i Blerësit (përfaqësuesi i Blerësit) do të përfaqësojë Blerësin në të gjitha çështjet sipas kësaj marrëveshjeje dhe për të gjitha qëllimet dhe synimet, pa kufizim, më saktësisht:

i) të jetë dakord me Shitësin dhe të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve, detyrë e Blerësit në bazë të kësaj marrëveshjeje;

ii) të gjitha komunikimet e çdo lloji të caktuar nga Shitësi për përfaqësuesin e Blerësit do të konsiderohet se janë dhënë rregullisht për Blerësin;

iii) të gjitha komunikimet e marra për Shitësin nga përfaqësuesi i Blerësit do të konsiderohen se janë dhënë ose marrë rregullisht nga ana e Blerësit; dhe

iv) përfaqësuesi i Blerësit në çdo kohë do të kryejë koordinimin dhe bashkëpunimin e duhur dhe efikas, dhe do të sigurojë që Blerësi dhe agjencia ekzekutive të kryejnë detyrat e tyre në këtë marrëveshje.

16.2 Njoftimet. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet, sipas kësaj marrëveshjeje ose në lidhje me këtë, do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se është dhënë rregullisht kur dërgohet me teleks, shërbimi korrier i regjistruar ose letër Palës së cilës i është dhënë në adresën e kësaj Pale specifikuar më poshtë ose në adresën tjetër që kjo Palë ka caktuar, duke njoftuar Palën duke i dhënë një njoftim të tillë, kërkesë ose komunikim.

Për Blerësin:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 222 8405
Faks: +355 4 225 8494
E-mail: sekretariazv1@minfin.gov.al

Për agjencinë ekzekutive:
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
Njësia e Menaxhimit të Projektit, rr. “Sami Frashëri”, nr. 4
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Tel.: +355 4 225 3345
Faks: +355 4 225 3345
E-mail: agaruli@abcom.al

Për Shitësin:
P.O. Box 5925, Jeddah-21432
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel.: +966 2 6361400
Faks: +966 2 6366871
E-mail: archives@isdb.org

Neni 17
**Të ndryshme**

17.1 Titujt në këtë marrëveshje janë vetëm për lehtësi dhe nuk janë menduar dhe nuk do të interpretohen për të ndryshuar, kufizuar ose zgjeruar në asnjë mënyrë objektin ose kuptimin e gjuhës të përmbajtur në këtë marrëveshje.

17.2 Përshkrimet dhe shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

17.3 Personi që nënshkruan këtë marrëveshje në emër të secilës Palë përfaqëson në këtë mënyrë dhe garanton Palën tjetër që ai ose ajo ka të drejtën dhe autoritetin e nevojshëm ligjor për të zbatuar këtë marrëveshje në emër të Palës dhe e lidh Palën me detyrimet e kësaj marrëveshjeje.

17.4 Kjo marrëveshje i lidh dhe i sjell dobi pasardhësve dhe të caktuarve përkatës të Palëve, me kusht që asnjëri prej tyre nuk mund të caktojë këtë marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, pa pëlqimin paraprak me shkrim të tjetrit.

17.5 Kjo marrëveshje është ekzekutuar në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat secila Palë do të marrë një origjinal.

17.6 Data e kësaj marrëveshje, për të gjitha qëllimet e kësaj marrëveshjeje, do të jetë ajo që jepet në parathënie.

[Fundi i neneve]

Faqe ekzekutimi:

Në dëshmi të kësaj, Palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në lidhje me financimin e punimeve për projektin e ndërtimit të Portit të Peshkimit në Durrës (ALB-0035) për një shumë që nuk tejkalon 7.580.000.00 USD (shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë), e barabartë afërsisht me 4,900,000.00 ID (katër milionë e nëntëqind mijë dinarë islamikë), në datën e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

_____
Emri:
Titulli:

PËR DHE NË EMËR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

_____
Emri:
Titulli:

## ANEKSI I
## PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Punimet që do të financohen nga IDB, do të jenë pjesë e infrastrukturës së portit siç përshkruhet më poshtë:

i) Rrugët paraprake dhe të aksesit (lidhur me nënkomponentët sipas Istisna'a). Ky nënkomponent lidhet me shpenzimet e mobilizimit dhe të çmobilizimit dhe ndërtimin e një rruge hyrëse 600 m të gjatë në portin e peshkimit jashtë valëpritëses ekzistuese kryesore dhe vendosur në plazh.

ii) Bankinë mbështetëse. Lëviz përgjatë gjatësisë së basenit për 175 m, bankina në breg do të formojë rrënjën e kalatave. Pontonët do të jenë 2 m të gjerë me një lartësi mbi ujë prej 0.6 m dhe do të furnizohen me ujë të pijshëm përgjatë gjatësisë së basenit për 175 m, bankina në breg do të formojë rrënjën e kalatave. Pontonët do të jenë 2 m të gjerë me një lartësi mbi ujë prej 0.6 m dhe do të furnizohen me ujë të pijshëm.

iii) Kalatat. Për zonën e ankorimit do të ndërtohen tri kalata. Të tria kalatat do të jenë të forta dhe secila do të jetë 81 metër e gjatë.

iv) Ndërtesat e portit dhe subjektet tregtare. Ndërtesat e portit të peshkimit do të përbëhen nga:

- ndërtesa FMO, 500 $m^2$ mbi 2 kate;
- blloku i higjienës, 35 $m^2$ dhe nënstacioni 9 $m^2$;
- vendrojë, 3 $m^2$ dhe zyra e shitjes së karburantit 1.8 $m^2$ (kabina modulare).

v) Shërbimet do të përbëhen nga:

- instalimi i sistemit të furnizimit me ujë;
- instalimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza do të lidhet me sistemin komunal;
- ndërtimi i objekteve të furnizimit të karburantit;
- instalimi i telefonit, komunikimit detar VHF dhe shërbime të tjera.

ANEKSI II
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i financimit suplementar të propozuar është që të sigurojë sektorin shqiptar të peshkimit në Durrës deri në vitin 2015, me një port të vendosur strategjik plotësisht operativ që siguron një strehë të sigurt, ku anijet e peshkimit mund të shkarkojnë ngarkesën e tyre, të marrin furnizime dhe të ankorojnë në mënyrë të sigurt kur nuk janë të angazhuar në operacionet e peshkimit.

Shtrirja e përgjithshme e projektit përfshin përbërësit e mëposhtëm:

A) Ndërtimi i objekteve të portit;

B) Shërbimet e konsulencës;

C) Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU);

D) Kontrolli financiar.

Kostoja totale e projektit, duke përfshirë financimin suplementar llogaritet në 18.43 milionë USD, i përbërë nga 10.86 milionë USD, në monedhën vendase, dhe 7.57 milionë USD në valutë të huaj.

Plani i propozuar i financimit të projektit është paraqitur në tabelën më poshtë:

*milion US$*

| Përbërës | IDB Kredi | GoA | Total | IDB (%) | IDB Istisna'a | GoA | Total | IDB (%) | Grand Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A – Ndërtimi i objekteve të portit** | | | | | | | | | |
| A1 – Rruga Kryesore & Aksesit | 0.30 | 0.07 | 0.37 | 82 | 1.78 | 0.00 | 1.78 | 100 | 2.15 |
| A2 – Bonifikimi i tokës (1.8 ha) | 1.37 | 0.30 | 1.67 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 1.67 |
| A3 – Valëpritësi kryesor(800 m) | 4.26 | 0.93 | 5.19 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 5.19 |
| A4 – Valëpritësi i mbrojtur nga era (96 m) | 0.61 | 0.14 | 0.75 | 82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.75 |
| A5 – Bankina në breg (175 m) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.76 | 0.00 | 0.76 | 100 | 0.76 |
| A6 – Kalatat (3) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 2.33 | 0.00 | 2.33 | 100 | 2.33 |
| A7 – Ndërtesat e portit & Subjektet tregtare | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.57 | 0.00 | 0.57 | 100 | 0.57 |
| A8 – Shërbime komunale | | | | | | | | | |
| i – Sistemi i furnizimit me ujë | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 1.02 | 0.00 | 1.02 | 100 | 1.02 |
| ii – Derdhja e ujrave të zeza | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.12 | 0.00 | 0.12 | 100 | 0.12 |
| iii – Furnizimi me karburant | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.01 | 0.00 | 0.01 | 100 | 0.01 |
| iv – Furnizimi me energji elektrike | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.00 | 0.32 | 0.32 | 0 | 0.32 |
| Ndërtimi nën-total i objekteve të portit | 6.54 | 1.44 | 7.98 | 82 | 6.59 | 0.32 | 6.91 | 95 | 14.89 |
| **B – Shërbimet e konsulencës** | | | | | | | | | |
| i – Projekt i detajuar i inxhinierisë | 0.17 | 0.00 | 0.17 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.17 |
| ii - Mbikëqyrja | 0.38 | 0.00 | 0.38 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.38 |
| Nën-totali i Shërbimeve të Konsulencës | 0.55 | 0.00 | 0.55 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.55 |
| **C – Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)** | | | | | | | | | |
| i - Pagat | 0.29 | 0.04 | 0.33 | 88 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.33 |
| ii – Kostua e Operimit | 0.18 | 0.00 | 0.18 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.18 |
| iii – Paisjet IT & mjetet 4WD | 0.01 | 0.00 | 0.01 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.01 |
| iv – Reparti fillestar & Vizita e Prezantimit | 0.02 | 0.00 | 0.02 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.02 |
| Nën-totali PMU | 0.50 | 0.04 | 0.54 | 93 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.54 |
| **D – Kontrolli Financiar** | 0.05 | 0.00 | 0.05 | 100 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0 | 0.05 |
| Kostua bazë | 7.64 | 1.48 | 9.12 | 84 | 6.59 | 0.32 | 6.91 | 95 | 16.03 |
| Kontingjencat fizike(10%) | 0.76 | 0.15 | 0.91 | | 0.66 | 0.03 | 0.69 | | 1.60 |
| Kontingjencat e çmimit(5%) | 0.38 | 0.07 | 0.45 | | 0.33 | 0.02 | 0.35 | | 0.80 |
| **I gjithë totali** | 8.78 | 1.70 | 10.48 | 84 | 7.58 | 0.37 | 7.95 | 95 | 18.43 |

Shënim. Financimi i Shitësit sipas shumës Istisna'a do të përdoret për të mbuluar koston totale të punimeve të përshkruara në aneksin I, të cilat janë të gjitha pjesë e komponentit ndërtimi i objekteve te portit. Komponentët e tjerë të projektit janë financuar në kuadër të kredisë aktive (ALB-0020), e cila do të mbulojë zërat e mbetur të ndërtimit të objekteve të portit, si dhe shërbimet e konsulencës, Njësinë e Menaxhimit të Projektit (PMU) dhe kontrollin financiar.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 13.5.2013
Doli nga shtypi më 13.5.2013

| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë